



GAZETA ZYRTARE

E REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

1978

4

GAZETA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE
TË SHQIPËRISË



Shtator

1978

Nr. 4

PËRMBAJTJA

I

1. Dekret nr. 5748 / datë 29.6.1978	Mbi caktimin e ditës së zgjedhjeve të Kuvendit Popullor.	69
2. Dekret nr. 5759 / datë 11.9.1978	Mbi disa ndryshime në ndarjen administrative tokësore të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.	70
3. Dekret nr. 5760 / datë 11.9.1978	Për dhënie e lejim lënjeje të shtetësisë.	71

II

1. Vendim nr. 32 / datë 24.3.1978	Për miratimin e rregullores «Për prodhimin, shpërndarjen dhe përdorimin e energjisë elektrike».	72
2. Vendim nr. 36 / datë 3.5.1978	Për miratimin e rregullores për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pendëve përmbytjet nga mbrojtjen nga përmbytjet.	83

Tirazhi: 7620 kopje

Format 1/16 60x88

Stash 2204-72

Shtypur Kombinati Poligrafik
Shtypshkronja Mihal Duri Tiranë 1978

D E K R E T

MBI

**CAKTIMIN E DITËS SË ZGJEDHJEVE TË KUVENDIT
POPULLOR**

Duke marrë parasysh se më 6 tetor të këtij viti mbaron afati i Legjislaturës së Tetë të Kuvendit Popullor, në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës dhe të nenit 26 të ligjit «Mbi zgjedhjet e Kuvendit Popullor»

**PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

V E N D O S I :

Zgjedhjet e deputetëve të Kuvendit Popullor për Legjislaturën e Nëntë të bëhen më datën 12 nëntor 1978, ditën e diel.

Ky dekret hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij.
Tiranë, më 29.6.1978
Nr. dekretit: 5748

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

S E K R E T A R I :
Telo Mezini

K R Y E T A R I :
Haxhi Lleshi

D E K R E T

MBI DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVE TOKËSORE TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 77 të Kushtetutës;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. Në rrëthin e Dibrës:

Fshati Lajthizë shkëputet nga fshati i bashkuar Fush-Lurë i rrëthit të Dibrës dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Klos të rrëthit të Mirditës.

II. Në rrëthin e Pogradecit:

1. Krijohet fshati Gurëbardhë dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Dunicë.

2. Krijohet fshati Buqezë dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Udënishtë.

3. Krijohet fshati i bashkuar Dunicë me fshatrat Dunicë dhe Gurëbardhë.

III. Në rrëthin e Skraparit:

Krijohet fshati Kovaçanj dhe lidhet me fshatin e bashkuar me qendër në Barç.

IV. Në rrëthin e Tropojës:

Fshati Rushtë-Shëngjergj hiqet nga ndarja administrative.

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

Tiranë, më 11.9.1978

Nr. i dekretit: 5759

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

S E K R E T A R I :
Telo Mezini

K R Y E T A R I :
Haxhi Lleshi

D E K R E T

PËR DHËNIE E LEJIM LËNIEJE TË SHTETËSISE

Në mbështetje të nenit 77, të Kushtetutës,

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
I REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

I. T'u jepet shtetësia shqiptare:

1. Athina Jani Llafazanit
2. Diturie Faslli Rizvanit
3. Sali Sadik Jakupit
4. Hajrie Beg Ulajt
5. Maria Jani Nikës
6. Liza Gaspër Fortiguerrës (Shllaku)

II. T'i lejohet lënia e shtetësisë shqiptare

Fetihe Reshit Qemalajt

Ky dekret hyn në fuqi më 11.X.1978.

Tiranë, më 11.9.1978

Nr. i dekretit: 5760

**PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË**

S E K R E T A R I :
Telo Mezini

K R Y E T A R I :
Haxhi Lleshi

II

KËSHILLI I MINISTRAVE
VENDIM

Nr. 32 dt. 24.3.1978

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES «PËR PRODHIMIN,
SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE»**

Me qëllim që të përcaktohen më mirë e më qartë dety-
rat dhe marrëdhëniet midis prodhuesit, shitësit dhe përdo-
ruesve të energjisë elektrike, Këshilli i Ministrave.

VENDOSI :

1. Miratimin e rregullores «Për prodhimin, shpërndarjen
dhe përdorimin e energjisë elektrike», që i bashkëngjitet kë-
tij vendimi.

2. Rregullorja «Mbi prodhimin, shpërndarjen dhe përdo-
rimin e energjisë elektrike e termike», miratuar me vendi-
min e Këshillit të Ministrave Nr. 29, datë 6.3.1969; pika 4
e kreut II e vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 232,
datë 12.12.1973, «Mbi planifikimin dhe evidentimin e ener-
gjisë elektrike», si edhe çdo dispozitë tjetër që vjen në ku-
ndërshtim me këtë rregullore, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
(MEHMET SHEHU)**

R R E G U L L O R E

PËR

PRODHIMIN, SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

I. Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike.
Administrimi dhe shfrytëzimi i veprave energetike.

Neni 1

Energjia elektrike prodhohet:

a) nga ndërmarrjet energetike të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, të gruipara në sistemin energjetik të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

b) nga ndërmarrjet e Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale dhe, vetëm në raste të veçanta, edhe nga ndërmarrjet e institucionet e tjera dhe kooperativat bujqësore, për nevojat e tyre, me miratim të ministrisë ose të institucionit tjetër qendror përkatës.

Neni 2

Prodhimi dhe shpërndarja e energjisë elektrike bëhet në këto shkallë tensioni nominal standard: 0,23 kV, 0,4 kV, 6 kV, 10 kV, 35 kV, 110 kV dhe 220 kV.

Tensionet e shkallëve të tjera mund të përdoren vetëm me miratim të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale.

Neni 3

Veprat energetike administrohen dhe shfrytëzohen:

Centralet elektrike me karakter kombëtar, nënstationet dhe linjat elektrike me tension 35 kV e lart, nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave.

Centralet elektrike me karakter lokal, linjat elektrike, pikat e transformimit me tension gjer në 10 kV dhe instalimet e brendshme të banesave shtetërore, nga Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale.

Bëjnë përjashtim nga këto rregulla:

a) Centralet, nënstacionet, pikat e transformimit dhe linjat elektrike të çdo tensioni që u shërbejnë vetëm objekteve të një kombinaci, uzine, ndërmarrjeje, institucioni apo nevojave të prodhimit të një kooperative bujqësore dhe që ndodhen brenda territorit të rrethuar të tyre, administrohen dhe shfrytëzohen nga vetë ato.

Nënstacionet e këtyre objekteve, kur kanë aparatura komutimi për lidhjen e unazave, administrohen dhe shfrytëzohen nga ndërmarrjet energjetike, në rrjetin e së cilës ndodhen këto nënstacione.

Kur në pikat e transformimit 6-10 kV të objekteve të mësipërme ka aparatura komutimi për lidhjen e unazave, manovrimet kryhen nga ndërmarrjet komunale ose me lejën e tyre nga ndërmarrjet që i kanë në administrim.

b) Rrjeti elektrik me tension më të ulët se 35 kV që i shërben industriisë së naftës dhe që administrohet e shfrytëzohet nga Drejtoria e Nxjerrjes së Naftës.

c) Linjat e tensionit të lartë dyfishe (me dy tensione), administrohen e shfrytëzohen nga ajo ndërmarrje, së cilës i përket shkalla e tensionit më të lartë.

d) Linjat elektrike provizore administrohen dhe shfrytëzohen nga ndërmarrja së cilës i shërbejnë.

Neni 4

Shfrytëzimi i veprave energjetike bëhet sipas rregullores së shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik. Në rast të kundërt, ndërmarrja shitëse ka të drejtë të ndërpresë furnizimin me energji elektrike.

Neni 5

Ndërtimet, që kërkojnë gjermime dhei ato në vendet ku kalojnë linjat elektrike ose në afërsi të objekteve energjetike, lejohen vetëm pasi të merret miratimi i ndërmarrjes që administron rrjetin. Shpenzimet, puna dhe materialet e nevojshme për zhvendosjen e linjave ose të objekteve energjetike përballohen nga investitori i veprës që ndërtohet dhe

kryhen nën drejtimin teknik të ndërmarrjes që administron linjën ose objektin energjetik.

Ndërmarrja që administron rrjetin ndalon punimet, kur këto bëhen në kundërshtim me rregulloren e shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik.

Pemët në afërsi të linjave elektrike, në distanca më të vogla se ato që përcaktohen në rregulloren e shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik, priten ose krasiten nga ndërmarrja, kooperativa bujqësore ose shtetasit, të cilëve u përkasin ato, me kërkesën e ndërmarrjes që administron rrjetin elektrik dhe nën mbikqyrjen e personelit elektrik të kësaj ndërmarrjeje. Në rast se ndërmarrja, kooperativa bujqësore ose shtetasi, me gjithë kërkesën e ndërmarrjes që administron rrjetin elektrik, nuk merr masa, prerja ose krasitja bëhet nga kjo e fundit.

II. Marrëdhëni midis prodhuesit — shitësit dhe përdoruesit të energjisë elektrike.

Neni 6

Përdorimi i energjisë elektrike lejohet kur midis ndërmarrjeve prodhuese — shitëse dhe përdoruese, është lidhur kontratë vjetore e ndarë në tremujorë dhe muaj sipas planit të miratuar. Për përdoruesit familjarë kontrata është një dhe e përbashkët pér dritë, ujë, qira dhe është pjesë e pandarë e kësaj rregulloreje (lidhja Nr. 1).

Neni 7

Lidhja e energjisë elektrike të përdoruesve brenda vi-jave kufitare deri në pikën e lidhjes, bëhet nga ndërmarrja shitëse me shpenzimet e saj, sipas planit vjetor, kur plotë-sohen kërkesat e mëposhtme:

a) Përdoruesit me fuqi të vendosur mbi 15 kW, kërkesën pér lidhje duhet t'ia bëjnë ndërmarrjes shitëse brenda datës 10 janar të çdo viti pér vitin pasardhës. Në rast të kundërt lidhja bëhet nga përdoruesi me fondet e materialet e tij.

b) Objektet nën 15 kW (përfshirë dhe ndërtesat e banimit), lidhen brenda 15 ditëve nga dita që ndërmarrjes shitëse i paraqitet kërkesa.

Pikëlidhje quhet:

Për centralet, nënstationet dhe pikat e transformimit, pika ku do të lidhet koka e kabllit ose fillimi i linjës ajrore.

Për linjat kabllore deri 10 kV, pika ku lidhet koka fundore e kabllit furnizues (tek aparati komutues, pajisjet e mbrojtjes së kuadrit, ose paneli kryesor i objektit që furnizohet).

Për rrjetet ajrore deri 10 kV, vendi ku lidhen fijet e fundit të linjës furnizuese, kasetë elektrike e ndërtesës, aparati matës i energjisë, ose konstruktioni metalik në hyrje të pikës së transformimit.

Rrjeti i brendshëm, duke përfshirë edhe pikën e lidhjes, ndërtohet me fondet dhe materialet e investitorit nga ndërmarrja që zbaton objektin.

Neni 8

Lidhja përfurnizim me energji elektrike bëhet nga ndërmarrja shitëse, kur përdoruesi i energjisë elektrike t'i ketë paraqitur asaj vërtetimin për zbatimin e punimeve sipas projektit e rregullores së shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik.

Përdoruesit e energjisë elektrike, me miratimin e ndërmarrjes energjetike e komunale, ku ushtron aktivitetin ndërmarrja përdoruese, mund të bëjnë shtesë të fuqisë së vendosur apo të ndërtojnë objekt të ri, brenda planit vjetor të energjisë elektrike.

Neni 9

Energjia elektrike, që harxhohet nga përdoruesit, planifikohet sipas normave të miratuara nga ministritë dhe institucionet e tjera qendrore përkatëse për njësi prodhimi, ndërtimi apo shërbimi.

Neni 10

Ndërmarrja shitëse ka të drejtë të kontrollojë në çdo kohë pajisjet e rrjetit elektrik të përdoruesit. Të metat, që vërehen gjatë kontrollit, rregullohen nga përdoruesi i energjisë, brenda afatit që përcakton ndërmarrja shitëse.

Neni 11

Ndërmarrjet prodhuese shitëse të energjisë elektrike janë të detyruara të mbajnë tensionin e energjisë elektrike të përdoruesve në kufijtë (\pm) 5 për qind të tensionit të lejuar.

Neni 12

Matja e konsumit të energjisë elektrike për çdo përdores bëhet me aparate njehsorë (kontatorë), të cilët janë pronë shtetërore e vendosen nga ndërmarrja shitëse, me shpenzimet e saj. Në mungesë të tyre energjia elektrike e harxhuar llogaritet dhe faturohet nga ndërmarrja shitëse në përpjesëtim me fuqinë e vendosur dhe orët e përdorimit. Në rastet kur harxhimi i energjisë elektrike i dy ose më shumë familjeve, që banojnë në një hyrje (apartament) ose banesë, por që nuk ka hyrje të veçantë për çdo familje, matet me një njehsor, vlefta e energjisë elektrike e harxhuar u faturohet nga ndërmarrja shitëse gjithë përdoruesve, në përpjesëtim me numrin dhe fuqinë e llampave, të mjeteve e të pajisjeve të tjera elektrike që përdorojnë.

Neni 13

Matja e energjisë elektrike e një përdoruesi, që furnizohet nëpërmjet linjave të tensionit 6 ose 10 kV, si rregull, bëhet në anën e tensionit të lartë.

Kur matja bëhet në tensionin e ulët, ndërmarrja shitëse i faturon përdoruesit edhe humbjet në transformator.

Neni 14

Përdoruesit e energjisë elektrike, lidhur me shkallën e sigurisë së furnizimit, ndahen në tri kategori sipas kriteve të caktuara, që janë pjesë e pandarë e këtij vendimi (lidhja Nr. 2). Ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, për çdo rast konkret, bëjnë kategorizimin e përdoruesve.

Neni 15

Përdoruesit e energjisë elektrike me fuqi të vendosur mbi 50 kW janë të detyruar të marrin të gjitha masat teknike dhe organizative për të siguruar koeficientin e fuqisë jo më të vogël se 0,85, si edhe të kursejnë energjinë elektrike. Investimet e nevojshme dhe sigurimi i pajisjeve përkëtë qëllim bëhen nga ndërmarrjet përdoruese.

Për ndërmarrjet e reja koeficienti i fuqisë **nuk** duhet të jetë më i vogël se 0,90.

Neni 16

Ndërmarrjet dhe kooperativat bujqësore, për objektet me fuqi të instaluar mbi 50 kW, në rast se realizojnë koefficient fuqie më të vogël se 0,85, do t'i paguajnë ndërmarrjes shitëse 0,05 lekë për çdo kWhr (kilovat-orë reaktiv) që shtohet nga keqësimi i këtij koeficienti.

Neni 17

Përdoruesit e energjisë elektrike që ushqehen nga sistemi energjetik, kur krijohen situata të jashtëzakonshme në furnizimin me energji elektrike, janë të detyruar t'u përmbahen grafikëve ditorë, mujorë dhe vjetorë të energjisë, si edhe kufirit të ngarkesës në orët e maksimumit, sipas detyrave që do të caktojë Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Ekonomisë Komunale.

Në rast se përdoruesit tejkalojnë kufijtë e caktuar dhe kur sistemi nuk është në gjendje të përballojë ngarkesën, ndërmarrjet prodhuese-shitëse bëjnë kufizimet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Ekonomisë Komunale.

Neni 18

Ndërmarrjet prodhuese — shitëse i ndërpresin energjinë elektrike përdoruesit kur:

- a) nuk lidh kontratë për harxhimin e energjisë elektrike;
- b) tejkalon planin mujor të energjisë elektrike të caktuar në kontratë, për aq kohë sa të vihet në vend harxhimi i tejkaluar.

Bëjnë përjashtim nga ky rregull ndërmarrjet, të cilave u rritet prodhimi për të shtuar eksportin, si edhe ato, të cilave u rrezikohet prishja e mallrave që kanë në proces dhe mund t'i sillen dëme ekonomisë. Në këtë rast ndryshimin e planit të përdorimit të energjisë elektrike mbi sasinë e planifikuar e bën ministria ose institucioni tjetër qendor përkates;

- c) pajisjet dhe instalimet elektrike të përdoruesit janë jashtë rregullave të shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik;
- g) përdoruesi nuk paguan energjinë elektrike në afatin e caktuar.

Për rastet e përmendura në pikat a, c, ç, të këtij nenit, lidhja e energjisë elektrike bëhet nga ndërmarrja shitëse brenda 24 orëve nga koha kur përdoruesi i energjisë ka plotësuar kërkesat e ndërmarrjes.

Kur përdoruesi prek aparatin matës, me qëllim që të marrë energji ose merr energji elektrike në rrugë të parregullt, inspektori i energjisë elektrike mban procesverbalin përkatës dhe bën kallëzimin për ndjekje penale.

Neni 19

Ndërmarrjet prodhuase e shitëse nuk mbajnë përgjegjësi ndaj përdoruesve për pasojat që mund të rrjedhin nga ndërprerja e energjisë elektrike për shkaqe të fuqisë madhore (shkarkime atmosferike, erëra të fuqishme, shembje, përbërje, tërmet, thatësirë, etj.), si edhe për defekte të padukshme në rrjetin elektrik.

Ndërmarrjet prodhuase e shitëse mbajnë përgjegjësi kur vërtetohet se për faj të tyre ndërpritet furnizimi me energji elektrike i përdoruesve dhe, si rezultat i kësaj, ka ardhur një dëm ekonomik. Në këtë rast furnizuesi i paguan përdoruesit një kusht penal baraz me 0,50 për qind në ditë për 10 ditët e para dhe për gjithë ditët e tjera edhe 8 për qind mbi çmimin e shitjes me shumicë të energjisë së pafurnizuar.

Lidhja Nr. 1

KONTRATE TIP

PËR

QIRA BANESE, FURNIZIM ME ENERGJI ELEKTRIKE DHE UJË

Sot më datën midis qiradhënësit Dega e Shitjes pranë Ndërmarrjes përfaqësuar prej dhe qiramarrësit, lidhet kjo kontratë:

1. Qiradhënësi në bazë të autorizimit të Komitetit Ekzekutiv, jep me qira shtëpinë ose apartamentin Nr. në Pallatin në Rrugën bashkë me inventarin që përmban aktdorëzimi, me qiranë mujore lekë nga muaji 19..., si edhe merr përsipër të furnizojë qiramarrësin me energji elektrike dhe ujë me çmimet që janë në fuqi.

2. Palët detyrohen të kryejnë ndreqjet që u përkasin dhe të respektojnë rregullat e mirëmbajtjes.

3. Qiramarrësi detyrohet të paguajë në afatin e caktuar vleftën e qirasë, të dritës dhe të ujit.

4. Për detyrimet që nuk parashikohen në këtë kontratë, zbatohen dispozitat për qiranë, ujin dhe energjinë elektrike.

QIRADHËNSI:
(.....)

QIRAMARRËSI:
(.....)

Lidhja Nr. 2

KRITERE PËR PËRCAKTIMIN E KATEGORIVE TË PËRDORUESVE TË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR SHKALLËN E SIGURISË SË FURNIZIMIT TË TYRE

Sipas shkallës së sigurimit të furnizimit me energji elektrike, përdoruesit ndahen në tri kategorë.

Në kategorinë e parë, hyjnë përdoruesit tek të cilët ndërprerja e furnizimit me energji elektrike shkakton rrezik për jetën e njerëzve, dëm të madh në ekonominë popullore, dëmtimin (shkatërrimin) e pajisjeve, prishjen në masë të prodhimit, prishjen e proceseve të ndërlikuara teknologjike, çregullim në aktivitetin e qyteteve kryesore.

Në kategorinë e dytë, hyjnë përdoruesit tek të cilët ndërprerja e furnizimit me energji elektrike shkakton ndërprerjen e prodhimit në sasi të mëdha, mbetjen pa punë në masë të punëtorëve, mekanizmave dhe transportit industrial, si edhe prishjen e aktivitetit normal të një numri të konsiderueshëm banorësh të qytetit.

Në kategorinë e tretë, hyjnë gjithë konsumatorët e tjera, që nuk përfshihen në kategorinë e parë e të dytë, si p.sh. repartet e prodhimit jo në seri, repartet ndihmëse, qytetet e vegjël, fshatrat, qendrat e banuara.

Përdoruesve të kategorisë së parë, duhet t'u sigurohet ushqim me energji elektrike nga dy burime të pavarura ose dy drejtime të pavarura. Ndërprerja e furnizimit të këtyre përdoruesve lejohet për kohën e futjes automatike të ushqimit rezervë.

Në ato raste, kur nuk justifikohet teknikisht dhe ekonomikisht sigurimi i burimit të dytë ose drejtimi i dytë i pavarur i energjisë elektrike, si burim i tillë mund të përdoren grupe diesel ose bateri akumulatorësh, që sigurohen nga vetë përdoruesi i energjisë elektrike.

Për përdoruesit e kategorisë së parë, me kërkësë të vëçantë përfurnizim me energji elektrike, përveç masave të mësipërme, nga ana e përdoruesit, të merren edhe masa të tjera suplementare, përrritjen e shkallës së sigurisë së furnizimit me energji elektrike.

Përdoruesve të kategorisë së dytë, duhet t'u sigurohet furnizimi me energji elektrike nga dy burime ose drejtime dhe lejohet ndërprerja e furnizimit me energji elektrike përf kohën që i duhet personelit të shërbimit përkryçjen e ushqimit rezervë.

Në ato raste, kur ka vetëm një burim furnizimi, lejohet furnizimi i përdoruesve të kategorisë së dytë vetëm me një linjë, ajrore ose kabllore dhe përk këtë të fundit linja duhet të ketë dy kabllo, që lidhen në pikat e vëçanta.

Për përdoruesit e kategorisë së tretë, lejohet ndërprerja e furnizimit me energji elektrike, përf kohën që duhet përremontin ose rregullimin e elementeve të dëmtuar të rrjetit elektrik.

V E N D I M

Nr. 36 dt. 3.5.1978

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES PËR RUAJTJEN DHE
MIRËMBAJTJEN E PENDËVE PËR MBROJTJEN NGA
PËRMBYTJET**

Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e rregullores për ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pendëve për mbrojtjen nga përbmytjet, që i bashkëngjitet këtij vendimi.

2. Rregullorja mbi ruajtjen e mirëmbajtjen e pendëve dhe mbrojtjen nga prurjet e mëdha të lumenjve, miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 361, datë 19.10.1963, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
(MEHMET SHEHU)**

R R E G U L L O R E

PËR

RUAJTJEN DHE MIRËMBAJTJEN E PENDËVE PËR MBROJTJEN NGA PËRMBYQTJET

Neni 1

Pendët janë vepra dheu ose zhavori, të veshura ose jo me lëndë të tjera, të ndërtuara gjatë lumenjve, përrenjve, bregut të detit, kanaleve të ujërave të larta, kanaleve rre-thuese, kanaleve kulluese, me qëllim që të mbrohen nga përmbytjet qendra të banuara, toka bujqësore ose vepra të tjera.

Neni 2

Ruajtja dhe mirëmbajtja e pendëve kanë për qëllim mbrojtjen e tyre nga dëmtimet, mbajtjen në gatishmëri të plotë për të përballuar prurjet e parashikuara në projektet përkatëse dhe, pas çdo dëmtimi, sado të vogël, rivendosjen me repektësi të kushteve të projektit, duke i quajtur këto kushte si një minimum të domosdoshëm.

Neni 3

Kategorizimi i pendëve bëhet nga Ministria e Bujqësisë.

Neni 4

Ruajtja dhe mirëmbajtja e pendëve të kategorisë së parë e të dytë bëhet nga drejtoritë e ujërave dhe të sistemimeve, ndërsa e pendëve të kategorisë së tretë nga drejtoritë e ujërave dhe të sistemimeve, ose nga ekonomitë bujqësore,

ose nga ndërmarrjet që i kanë në përdorim, sipas ndarjes që miratohet nga komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve.

Drejtoritë e ujërave dhe të sistemimeve kanë përgjegjësi dhe ushtrojnë kontroll shtetëror edhe në pendët e kategorisë së tretë që ruhen dhe mirëmbahen nga ekonomitë bujqësore ose ndërmarrjet e tjera që i kanë në përdorim.

Neni 5

Detyrat kryesore të drejtorive të ujërave dhe të sistemimeve të ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore që ngarkohen me ruajtjen dhe mirëmbajtjen e pendëve janë:

- a) sigurojnë ruajtjen e pendëve nga dëmtimet;
- b) sigurojnë ndreqjen e dëmtimeve që pësojnë pendët për shkaqe të ndryshme, bëjnë dhe mirëmbajnë veshjen e tyre me bar;
- c) sigurojnë që sopi (toka midis shtratit të lumit dhe pendës) të ruhet gjithnjë i lirë dhe pa pengesa sipas parashikimit të projektit dhe të mos hapen në të rrjedhje të reja uji;
- ç) mirëmbajnë veprat e ndërtuara në shtratin e lumenit për mbrojtjen e brigjeve nga gërryerjet (cfrate ose pendë tërthore, veshje e të tjera) dhe kryejnë punime të tillakur paraqitet nevoja.
- d) vendosin reperet e kuotave, gurët kilometrikë, lata hidrometrike, shenjat e niveleve karakteristike, mbajnë në rregull dhe vazhdimisht të azhurnuar dokumentacionin teknik të pendëve që administrojnë;
- dh) mirëmbajnë rrugët e shërbimit të pendëve;
- e) planifikojnë dhe ruajnë materialet rezervë për mbrojtjen e pendëve;
- ë) përpunojnë, në kushtet konkrete të pendëve të ndryshme, përvojën që krijohet gjatë mirëmbajtjes, të kalimit të plotave dhe, në përputhje me këtë, përcaktojnë dhe zbatojnë masat përkatëse dhe bëjnë propozimet që shohin të nevojshme.

Neni 6

Ndalohet kalimi i automjeteve, mekanizmave të ndryshme dhe i qerreve mbi pendët, me përjashtim të rasteve

kur në projekt është parashikuar që këto të shërbejnë edhe si rrugë, si edhe të mjeteve që punojnë për mirëmbajtjen dhe ndreqjen e vetë pendës.

Kalimi i automjeteve, i mekanizmave, i qerreve dhe i bagëtive tërthor pendëve, lejohet vetëm në vendekalime të posaçme të caktuara nga drejtoria e ujërave dhe e sistemeve.

Në raste të veçanta, me miratim të komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrëthit, mund të ndalohet kalimi i këmbësorëve mbi pendë.

Neni 7

Për mbrojtjen e pendëve dhe për sigurimin e një pjese të lëndës drunore në vend, nga ana e jashtme mund të mbillen breza pyjorë, jo më afër se katër metra nga rrëza e brinjës së pendës.

Për pendët e kategorisë së parë dhe të dytë gjerësia e këtyre brezave, kur nuk është përcaktuar në projekt, miratohet nga Ministria e Bujqësisë.

Brezat pyjorë të pendëve mirëmbahen dhe shfrytëzohen nga drejtoritë e ujërave dhe të sistemimeve. Prerja e tyre bëhet me lejen e ndërmarrjeve pyjore të rrëtheve.

Ndalohet mbjellja e çdo lloj druri në trupin e pendëve dhe në brezin katër metrë të gjerë të matur nga rrëza e brinjës së pendëve nga ana e ujtit.

Neni 8

Pendët e kategorisë së parë ndahanë në trungje 4-6 km të gjatë. Ruajtja dhe mirëmbajtja e një trungu i ngarkohen një punëtori me banim në qendrën më të afërt.

Pendët e kategorisë së dytë ndahanë në trungje me gjatësi më të madhe se 6 km.

Neni 9

Detyrat kryesore të punëtorit të mirëmbajtjes janë:

a) shkel në çdo stinë dhe në çdo kohë, i pajisur me vegla pune, jo më rrallë se një herë në ditë, të gjithë trungun e pendës që i është ngarkuar;

b) ndreq dëmet e vogla që vërehen në pendë, si shkarje, gërryerje, ulje e të tjera, vrimat që hapen nga kafshët, si

urithi, miu i fushës e tjera, mbush plasat që krijohen në kohën e thatësirës, mban vazhdimisht të pastër trupin e pendës nga filizat e drurëve, nga ferrat, drizat e tjera;

c) plotëson dhe përmirëson veshjen e pendës, kosit dhe grumbullon barin e saj;

c) ruan dhe mirëmban materialet rezervë në magazinën e trungut, ose që janë vendosur gjatë saj;

d) harton procesverbalin për konstatimin e shkeljes së rregullave për mbrojtjen e pendëve dhe njofton organet përkatëse për dëmtimin e tyre.

Neni 10

Për të siguruar gatishmërinë fillestare, në çdo rast rrezziku ose dëmtimi të pendëve, në magazinat e trungjeve dhe në magazinën qendrore të drejtorisë së ujërave dhe të sistemimeve, në atë të sektorit të saj, ruhen në çdo kohë sasitë e materialeve dhe mjetet rezervë, sipas normativave që përcaktohen në lidhjen e bashkëngjitur kësaj rregulloreje.

Përdorimi i këtyre materialeve dhe i mjeteve për çfarëdo qëllimi tjetër, përvèç mbrojtjes së pendëve, është krejtësisht i ndaluar. Materialet rezervë që përdoren për mbrojtjen e pendëve dhe mjetet e veglat e punës që dalin jashtë përdorimit, zëvendësohen menjëherë.

Neni 11

Gjatë kalimit të prurjeve të mëdha të lumenjve, njoftimi mbi nivelet dhe prurjet e ujit bëhet nga Instituti Hidrometeorologjik i Akademisë së Shkencave.

Pika hidrometrike, pér të cilat duhet të jepen njoftimet dhe mënyra e dhënies së njoftimeve, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë, të Institutit Hidrometeorologjik dhe të Drejtorisë së Postave dhe të Telekomunikacioneve.

Neni 12

Për pendët e kategorisë së parë gjatë kalimit të plotave të mëdha të lumenjve dallohet gjendja e mbikqyrjes dhe gjendja e rrezikut.

Nivelet e ujit, në të cilat fillon gjendja e mbikqyrjes, përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe të Institutit Hidrometeorologjik.

Gjatë gjendjes së mbikqyrjes, drejtoria e ujërave dhe e sistemimeve mban lidhje të vazhdueshme me shërbimin hidrometeorologjik dhe me personelin e vet, organizon mbikqyrjen e rrjedhjes së ujit gjatë pendëve, vlerëson sipas kushteve nëse krijohet ose jo gjendja e rrezikut dhe mban vazhdimisht në dijeni komitetin ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit.

Gjendja e rrezikut shpallet nga kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, kur njoftohet se uji është ngritur ose mund të ngrihet në nivelin e parashikuar në projekt, si edhe kur rrezikohet çarje e pendës nga gërryerjet ose filtrimet, pavarësisht nga niveli i ujit.

Në të njëjtën mënyrë si në pendët e kategorisë së parë, kur shihet e nevojshme, mund të shpallet gjendja e rrezikut edhe në pendët e kategorisë së dytë.

Neni 13

Masat e jashtëzakonshme për mbrojtjen e pendëve gjatë gjendjes së rrezikut, për ndreqjen e çarjeve që mund të ndodhin dhe për mënjanimin e dëmeve nga përmbytjet, drejtohen nga komisioni kundër përmbytjeve i kryesuar nga kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, me anëtarë: zëvendëskryetarin e komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit, drejtorin dhe kryeinshinierin e drejtorisë së ujërave dhe të sistemimeve, kryetarin e degës së punëve të brendshme dhe përfaqësuesin e komandës së repartit ushtarak më të afërt.

Gjatë kohës që vazhdon gjendja e rrezikut kryetari i komitetit ekzekutiv të këshillit popullor të rrethit ka të drejtë:

a) të dërgojë, ku e sheh të nevojshme, për mbrojtjen e pendës mjete, kuadro dhe punëtorë të ndërmarrjeve dhe të institucioneve që punojnë brenda kufijve të rrethit, me përjashtim të atyre ushtarakë e të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si edhe popullsinë e aftë për punë të qendrave të banuara afër pendëve;

b) të marrë masa për largimin e popullsisë dhe të bogaçive nga vendet e kërcënua.

Neni 14

Drejtoria e Postave dhe e Telekomunikacioneve, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, vendos shërbimin te-

lefonik në pendët e kategorisë së parë. Investimet për rrjetin telefonik përballohen nga Ministria e Bujqësisë.

Neni 15

Kalimi i automjeteve, i mekanizmave të ndryshme, i qerreve dhe i bagëtive mbi pendë jashtë vendeve të caktuara, si edhe çdo shkelje tjetër që u shkakton dëm pendëve, kur nuk përbën vepër penale, dënohen si kundërvajtje administrative me qortim shoqëror ose me gjobë deri në 500 lekë nga gjykatat e fshatrave, të qyteteve dhe të lagjeve të qyteteve.

**NORMATIVAT MINIMALE TE MATERIALEVE DHE MJETEVE QE DUHET TE RUHEN NGA DREJTO-
RITE E UJERAVE DHE TE SISTEMIMEVE PER GATISHMÉRINE E RUAJTJES SE PENDÈVE**

Nr.	Lloji materialit	Njësia	Normativa mesatare për çdo trung			Kategorie e dytë
			Kategoria e parë	Velipojë Drin Buni — Gjadër	Shtukumbin	
1.	Thasë të vjetër lini ose nejioni ,	copë	800	200	300	200
2.	Gurë	m ³	300	200	250	200
3.	Rrijet teli për gabiona	m ²	800	300	300	200
4.	Lëndë druri me diametër 15 — 20 cm	m ³	2	1	1	—
5.	Dërrasa të ndryshme	m ³	3	2	2	2
6.	Lopata	copë	20	20	20	15
7.	Kazma	"	5	5	5	3
8.	Sepata	"	4	4	4	4
9.	Batipal dore	"	4	4	4	4
10.	Ganxha	"	200	200	200	150
11.	Fenerë dhe elektrikë	"	5	5	5	4

Shënim: Materialet dhe mjetet e mësipërmë ruhen pjesërisht në magazinat e trungeve, sipas ndarjes që drejtoria e ujërave dhe e sistemeve shëht të arsyeshme në bazë të përvojës së fituar.
 Gurët depozitohen gjatë trungeve dhe në vendë të tjera ku mund të transportohen me lehë. Per pendët e kategorisë së trete, sasitë e materialeve dhe të mijteve përcaktohen nga vete drejtoritë e ujërave dhe të sistemimeve.

Emimi 1,50 lekë